

KUD 811.18'373.4

FJALA SHQIPE NË VEND TË FJALËS SË HUAJ

Dr. Xhavit Aliçkaj, prof. ass.

Abstrakt

Duke u mbështetur në shkrimet e përditshme gazetareske, në shkrime të ndryshme që kanë karakter studimor dhe në fjalimet, bisedat, intervistat e intelektualëve të profesioneve të ndryshme, vërejmë dukurinë e përdorimi të një numri të madh të fjalëve të huaja, të cilat e dëmtojnë gjuhën shqipe, dhe të cilat kanë mundësi të zëvendësohen me fjalë të burimit shqip.

Në këtë punim po japim një fjalorth të fjalëve të huaja që hasen më së shpeshti dhe fjalët me kuptim shqip që mund të përdoren në vend të tyre.

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj

Me gjithë të dhënë historike se gjuhët ndikohen prej njëra-tjetrës, pra marrin dhe japin, me gjithë faktin se gjuha shqipe e nënshruar shtresimeve të gjuhëve të pushtuesve të shumtë e të gjatë në këto troje dhe me gjithë faktin tjetër se terminologjia e shpikjeve të ndryshme depërton bashkë me mjetin e shpikur kemi obligim shkencor, kombëtar e moral që ta ruajmë gjuhën tonë nga invadimi (pushtimi) i fjalëve të huaja, sidomos në ditët tona.

Po të ndalemi në historikun e gjuhës shqipe nëpër periudha të ndryshme, po t'i shikojmë përpjekjet e gjuhëtarëve, intelektualëve dhe mësuesve (edhe atyre fetarë) se ç'kanë bërë e ç'kanë rrezikuar për ta ruajtur dhe mësuar gjuhën shqipe dhe kanë ruajtur ndër shekuj, që është sa befasi e madhe aq edhe meritë e tyre, kur dihet me çfarë pushtuesish kanë pasur të bëjnë, atëherë në ditëton tona mbetet ta duam, ta mësojmë, ta begatojmë me forma të ndryshme dhe ta ruajmë nga përdorimi gjithnjë e më i madh i fjalëve të huaja.

Në rastet kur kemi mundësi ta përdorim fjalën shqipe, kur gjuha jonë ka përparuar dhe është begatuar me fjalë të reja dhe ka ende mundësi të gjejmë nga burimi autokton yni, t'u shmangemi fjalëve të huaja, të cilat e lëndojnë, e varfërojnë, e rëndojnë gjuhën tonë të bukur dhe i bëhen si mish i egër në trungun e gjuhës.

Më duket se është bërë modë dhe shprehi e një pjese intelektualësh të përporin fjalë të huaja për të treguar se dinë, se kanë kulturë evropiane ose ndonjëherë edhe me qëllim të errësimit të mendimeve.

Fjalë të tilla përdoren jo vetëm në fjalimet e politikanëve, shtypin e përditshëm, por edhe në shkrime shkencore të fushave të ndryshme studimore, të cilat përkundër faktit që kanë stilin e vet dhe leksikun profesional, duhet bërë përpjekje që të gjendet fjala shqipe e të përdoret në vend të fjalës së huaj.

Prandaj edhe në këtë punim , në këtë revistë shkencore-profesionale, ku dominojnë lëndët nga fusha e ekonomisë, biznesit dhe turizmit do t'i shënojmë fjalët e huaja, të cilat kanë mundësi të zëvendësohen me fjalë shqipe, ku edhe këta lëmenj e gjejnë veten. Tek e fundit gjuha shqipe është e kombit tonë; gjuhë e shkencës dhe gjuhë mësimore, kendej le t'u shërbejë të gjithëve si një kulturë më e begatë gjuhësore.

Për këtë arsye edhe lënda Shkrimi akademik duhet të ketë si parim kujdesin në përdorimin e fjalëve të huaja, të cilat, siç e cekëm, jo vetëm e dëmtojnë gjuhën tonë, por e bëjnë të pakuptueshme.

Pavarësisht nga fushat studimore dhe fjalori specifik i tyre, duhet bërë përpjekje për gjetjen e fjalës shqipe, kur ka mundësi. Për këtë duhet komentuar fjalori i gjuhës shqipe, fjalori i fjalëve të huaja dhe fjalorë terminologjikë të shkencave të ndryshme. Tani këtu po jepim një fjalor të vogël të fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen me fjalë shqipe :

	A	
abonoi	=	pajtoj
abuzoi	=	shpërdoroi
abandonim	=	braktisje
adaptoj	=	përshtat
adaptim	=	birëzim
aderoj	=	i bashkohem
abnegacion	=	vetëmohim
abrogim	=	shfuqizim, shlyerje, heqje
adash	=	emnak
afeksion	=	përmallim, përzemërsi
aglutinim	=	përngjitje
akoma	=	ende
aksident	=	fatkeqësi
akomodim	=	rregullim, përshtatje
alternancë	=	këmbim
ambient	=	mjedis
ambientohem	=	mësohem, përshtatem
anomali	=	parregullsi
aparencë	=	dukje, pamje e jashtme
aproksimativ	=	synim, dëshirë
asete	=	pasuri, pronë
auditiv	=	dëgjimor
avansim	=	përparim

	B	
barrierë	=	pengesë
bile	=	madje

brefing	=	konferencë shtypi
bord	=	këshill, komision
brutal	=	i ashpër, i vrazhdë

C

cedin	=	tërheqje, lëshim
-------	---	------------------

D

dakord	=	pajtohem, pranoj, jemi të një mendimi
decidoj	=	vendos
dedikoj	=	i kushtoj, kushtone
deformim	=	shformim
degjenerim	=	zvetnim
dekadencë	=	rënie
dekompozoj	=	shpërbërje
destinacion	=	drejtim, vendarritje
devijim	=	shmangie
deziluzion	=	zhgënjnim
decidiv	=	i vendsour
determinim	=	përcaktim
devotshmëri	=	përkushtim
denoncim	=	kallëzim
diferencë	=	dallim

F

filantrop	=	bëmirës
frakturë	=	thyerje
fertilitet	=	pjellshmëri
fiksim	=	ngulitje
fiasko	=	dështim
fiskal	=	tatimor
fidbek	=	prapaveprim, reagim
flesh	=	shkurt (lajme të shkurta)
frustrim	=	mashttrim, zhgënjim
funebër	=	mortor, përmotshëm

G

grimasë	=	ngërdheshje
---------	---	-------------

glosar	=	fjalës
grant	=	dhuratë, bursë, ndihmë, financë

I

i spostuar	=	i zhvendosur
iluzor	=	i rremë, i kotë
impotent	=	i pafuqishëm, i kapitur
indinjatë	=	zemërim
inkorporim	=	përfshirje, mishërim
insuficiencë	=	pamjaftueshmëri
intencë	=	synim, qëllim
interferim	=	ndërveprim, ndërmjetësim
involvim	=	përzierje
irrelevant	=	i parëndësishëm
itinerar	=	rrugëtim
impenjim	=	përkushtim

D

difensiv	=	mbrojtje e fortë
dislokim	=	zhvendosje (trupash)
disproporcion	=	shpërpjesëtim
distancë	=	largësi
divorc	=	ndarje
divulgim	=	popullarizim
divergjencë	=	mosmarrëveshje
dopio	=	dyfish
draft	=	plan, skicë, projekt

E

ofiçencë	=	gatishmëri, gjendje pune
eklatant	=	i famshëm, i shkëlqyeshëm
ekskluziv	=	i veçantë
eksplisit	=	i dobishëm, i qartë
ekuivok	=	i dykuptimshëm
ekzagjerim	=	zmadhim, tepri në diçka
ekzigjencë	=	kërkim, nevojë
enorme	=	e parregullt, e jashtëzakonshme
eskalim	=	shkallëzim, përshtatje
eveniment	=	ndodhi, ngjarje e rëndë
ekstradim	=	dorëzim

evitim	=	shmangie
eksploatim	=	shfrytëzim
ekuivalent	=	barasvlerë

I

investigoj	=	hetoj
ilaritet	=	të qeshura, me tallje
interceptoj	=	kap, ndërkap
impozant	=	madhështor, hijerëndë
impakt	=	efekt, përplasje
inJORANCë	=	padituri, pa dije

K

kakofoni	=	keqtingëllim
kauzë	=	çështje
kauzal	=	shkakor
kapricipoz	=	tekanjor, njeri me teke
koincidencë	=	përkim, përputhje
konciz	=	i ngjeshur, i thukët
konfidencë	=	mirëbesim
konform	=	në pajtim me , në përputhje me
konsulent	=	këshillues
komponent	=	përbërës
kredibilitet	=	besueshmëri
kompeticion	=	garë
konfondim	=	ngatërrim (i gjërave)
konsensus	=	bashkëpëlqim
kolandim	=	pranim, vërtetim
kolumne	=	rubrikë, shtyllë në gazetë
krucial	=	vendimtar, i ashpër
konstituiv	=	i vazhdueshëm
koshient	=	i ndërgjegjshëm
kredibil	=	i besueshëm
kurent	=	bashkëkohor

L

lider	=	prijës, udhëheqës
leadership	=	kreu, udhëheqësi
lansoj	=	hedh në qarkullim

M

meskim	=	shpirtvogël
megaloman	=	mendjemadh
mocion	=	propozim
mediator	=	ndërmjetës

N

neglizhencë	=	mospërfillje, pakujdesi
nominim	=	emërim

O

oficial	=	zyrtar
opcion	=	zgjedhje
panel	=	trup gjykues, juri
patronazh	=	përkujdesje
penetrim	=	depërtim
perfid	=	dhëlpërak, i pabesë
permanent	=	i përhershëm
performancë	=	kryerje, përfundim i një pune
pragmatik	=	praktik
precedencë	=	përparësi
prestigjioz	=	me cilësi të larta
profanim	=	përdhosje, poshtërim
prolongim	=	zgjatje, zvarritje
prononcim	=	shprehje, deklaram
provizor	=	i përkohshëm
promocion	=	gradim, ngritje në post

R

relaksim	=	çlodhje, pushim
revidim	=	rishqyrtim

S

satisfkaksion	=	kënaqësi, shpagim
spostim	=	zhvendosje
slogan	=	parullë, frazë

solucion	=	sqarim,zgjidhje
sondazh	=	vëzhgim
sublim	=	i madhërishëm

T

tender	=	ofertë, konkurs
trend	=	drejtim, synim
tretman	=	trajnim
triumf	=	ngadhnjim
turbulencë	=	rrëmujë
tutelë	=	kujdeestari (për fëmijë)

V

valid	=	i vlefshëm
versnik	=	moshatar
violencë	=	dhunë
viadukt	=	mbikalim
verdikt	=	vendim

XH

xhentil	=	i sjellshëm
---------	---	-------------

Përfundim

Me shënimin e këtyre fjalëve që përdoren pa nevojë në shkrimet e përditshme ua kemi ofruar një mundësi të mirë të gjithë atyre që do t'i lexojnë, që t'u shmangen sa të kenë mundësi dhe të flasin e të shkruajnë shqip. Mendojmë se kemi fjalë të mjaftueshme që t'i përdorim qoftë në shkrime të lira, gazetareske, po edhe shkencore.

Literatura

1. ASHA e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Për Pastërtinë e Gjuhës Shqipe, Tiranë 1998
2. Kryeziu, Dr.Bahtijar. Si të flasin e të shkruajmë drejt, libri shkollor, Prishtinë, 2006
3. Murati, Dr.Qemal, Gjuha e mediave, IA.,Prishtinë.2008
4. Shkurtaç, Gjovalin. Si të shkruajmë shqip. Toena, Tiranë 2008

Botues / Izdovac / Editor

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit – Pejë

ADMINISTRIM BIZNESI

Revistë shkencore shoqërore – ekonomike

KUD 65:338

Nr. 2

ADMINISTRIRANJE BIZNISA

Ekonomsko – društvena znanstvena revija

KUD 65:338

Br. 2

BUSINESS ADMINISTRATION

Economic and Social Scientific Journal

KUD 65:338

Vol. 2

Botimin e kësaj reviste e mundësoi Z Mobile nga Devolli Group



=====